



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 823/3 Prot.

Tiranë, më 21/04 2026

VENDIM
Nr. 58 datë 21/04 2026
PËR

NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE INSTITUTIT SHQIPTAR TË SOCIOLOGJISË

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin të Rektoratit nr. 62 datë 15/04/2026**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21/04/2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës** dhe **Institutit Shqiptar të Sociologjisë**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





DRAFT - MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
ndërmjet
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
dhe
INSTITUTIT SHQIPTAR TË SOCIOLOGJISË

Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet palëve, në funksion të mbështetjes së ndërsjellë për realizimin e misioneve të tyre dhe nxitjen e zhvillimit ndërdisiplinor të shkencave.

Neni 2
Fushat e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në këto drejtime:

- shkëmbimi i përvojave akademike, botimeve dhe teksteve shkencore;
- vënia në dispozicion e literaturës shkencore për stafin akademik dhe bashkëpunëtorët;
- krijimi i një rrjeti të përbashkët komunikimi dhe promovimi i aktiviteteve në mediat dhe faqet zyrtare;
- organizimi i aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore.

Neni 3
Projekte Kërkimore

Palët angazhohen për hartimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore me fokus empirik dhe/ose testues në fusha si:

- aktiviteti fizik dhe gjithëpërfshirja;
- aktiviteti fizik dhe pabarazitë sociale;
- aksesimi në sport sipas kategorive sociale;
- ndikimi i sportit në integrimin social të të rinjve;
- shëndeti, mirëqenia dhe stili i jetesës;



- marrëdhënia midis aktivitetit fizik dhe shëndetit mendor;
- obeziteti dhe jeta sedentare;
- ndikimi i sportit në edukim dhe zhvillim social;
- stereotipet gjinore në edukimin fizik;
- roli i mediave dhe rrjeteve sociale në perceptimin e trupit;
- sporti dhe identiteti kombëtar;
- sporti dhe teknologjia;
- politikat publike të sportit;
- hapësirat publike dhe aktiviteti fizik;
- sporti si mjet terapeutik dhe për kategori me nevoja të veçanta.

Neni 4

Organizimi i Aktiviteteve Shkencore

Palët do të organizojnë së bashku por edhe me institucione të tjera partnere:

- konferenca shkencore ndërdisiplinore;
- simpoziume;
- forume akademike;
- seminare;
- leksione të hapura;
- trajnime dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

Neni 5

Komisioni i Përbashkët

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të caktojnë një komision të përbashkët, përbërja e të cilit përcaktohet nga nënshkruesit e marrëveshjes.

Ky komision ka për detyrë:

- koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve;
- planifikimin dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta, përfshirë konferenca, forume, seminare dhe evente të tjera shkencore;
- ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
-



Neni 6 Kohëzgjatja dhe Përfundimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe nuk kufizohet në kohë. Çdo mosmarrëveshje që buron nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve ndërmjet Palëve.

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë me kërkesën e njëres palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën gjashtë muaj më parë.

Neni 7 Dispozita Përfundimtare

Kjo marrëveshje hartohet në 3 (tre kopje), nënshkruhet nga titullarët e institucioneve respektive dhe merr fuqi zbatuese për institucionet përkatëse nga data e nënshkrimit të saj.

Rektor i Universitetit të Sporteve
të Tiranës
Prof. Dr. Agron KASA

Drejtor i Institutit të Sociologjisë
Prof. Dr. Leke SOKOLI